



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Harmonizimi i Politikave Revizionuese për Statistikat Makroekonomike

Nëntor 2019

I. Hyrje

1.1 Revizionimet dhe rëndësia e tyre

Instituti i Statistikave ([INSTAT](#)) si prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor në Shqipëri, ka si qëllim prodhimin e statistikave në një kohë sa më të shkurtër dhe me një cilësi sa më të lartë, dhe që synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme.

Programi i Statistikave Zyrtare ([PSZ](#)) është dokumenti bazë që përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor për periudhën pesëvjeçare, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore.

Instituti i Statistikave (INSTAT) duhet të njoftojë institucionet e tjera dhe përdoruesit e statistikave makroekonomike lidhur me revizionimet, arsyet përse ndodhin dhe metodologjinë ku bazohen këto ndryshime. INSTAT ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ([MFE](#)) si dhe me Bankën e Shqipërisë ([BSH](#)) si institucionet më të rëndësishme të prodhimit të statistikave për të marrë parasysh këto ndryshime të treguesve të statistikave makroekonomike të cilat kanë një impakt të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Gjithashtu INSTAT ka përgjegjësinë për të komunikuar përdoruesit kryesorë të statistikave makroekonomike, në takimet apo mbledhje që organizohen brenda dhe jashtë institucionit.

Në vitin 2014, të gjitha vendet anëtare të BE-së prodhuan statistikat e tyre me të dhënat e revizionuara sipas Sistemit Evropian të Llogarive ([ESA 2010](#)). Kjo politikë revizionimi u aplikua edhe për prodhimin e statistikave për vendet jo-antare të BE-së në mënyrë që të jenë të krahasueshme midis tyre. Bazuar në politikat e revizionimeve, [EUROSTAT](#) komunikon se revizionimet e ardhshme të mëdha ose standarte do të jenë respektivisht në vitin 2019 dhe 2024.

Pritet që shumica e vendeve të BE-së do të jenë në gjendje të përmbushin këtë objektiv brenda vitit 2019 dhe që të gjitha vendet e BE-së do të ndërmarrin revizionimin e tjetër që i referohet vitit 2024. Prodhimi i treguesve pas revizionimeve përfshijnë rishikimin e statistikave të të dhënave, ose të paktën një pjesë të madhe të serive kohore.

Në mënyrë që statistikat të jenë të krahasueshme midis vendeve janë krijuar “Sistemi Statistikor Evropian” ([ESS](#)) dhe “Sistemi Evropian i Bankave Qendrore” ([ESCB](#)) të cilat ndihmojnë në arritjen e një ekuilibri midis përfshirjes së revizionimeve të nevojshme statistikore dhe mbajtjes së një shkalle të pranueshme të konsistencës të prodhimit të statistikave nga institucionet ndërkombëtare. Për këtë qëllim, të dy sistemet kanë punuar së bashku për të hartuar udhëzime për një politikë të harmonizuar të revizionimeve të statistikave makroekonomike.

Politikat e revizionimeve zënë një pjesë thelbësore në përpilimin e Llogarive Kombëtare Tremujore dhe Llogarive Kombëtare Vjetore në Shqipëri. Të gjitha revizionimet duhet të zbatohen sipas një politike të vendosur ku qëllimi kryesor është të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive për të zvogëluar mospërputhjet. Politika e revizionimeve për statistikat makroekonomike e ndjekur nga INSTAT bazohet në Politikën Evropiane të Harmonizuar të Revizionimit të treguesve makroekonomikë ([Harmonised European Revision Policy](#)), si dhe në manuale të tjera të publikuara nga EUROSTAT, ku përcaktohen politikat që duhen ndjekur nga institutet e prodhimit të statistikave të vendeve të ndryshme për ti bërë të krahasueshme këto

statistika me vendet e tjera. Përdoruesit në përgjithësi kërkojnë të dhënat më të fundit lidhur me treguesit kryesorë makroekonomikë, sa më shpejtë të jetë e mundur, veçanërisht në tregues të rëndësishëm si Produkti i Brendshëm Bruto ([PBB](#)).

Për të siguruar të dhëna në kohë, të dhënat paraprake që i nënshtrohen një shkalle të pasigurisë llogariten dhe publikohen për fusha të ndryshme statistikore, duke u bazuar në një bazë të dhënash e cila ende është e paplotë në atë kohë. Kur të dhënat janë përfunduar gjatë kohës, rezultatet e paraprake zëvendësohen me rezultate të cilësisë më të lartë (të cilat janë korrigjuar dhe bazuar në burimet e të dhënave më të fundit) të njohura me termin revizionime.

Revizionimet janë përkufizuar si "çdo ndryshim në një vlerë të statistikave të publikuara".

Revizionimet e statistikave makroekonomike janë të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e statistikave të një vendi, por mund të jenë të papërshtatshme për përdoruesit. Për të minimizuar këtë shqetësim, revizionimet duhen të koordinohen brenda një vendi dhe pastaj edhe me vendet e tjera.

1.2 Politika e revizionimeve

Themelimi i një politike revizionimi është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit dhe rritjes së cilësisë së prodhimit dhe publikimit të treguesve statistikorë.

Një politikë e revizionimit duhet të njihet si një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të duhur të prodhimit të statistikave, ndërsa menaxhimi i duhur i prodhimit të statistikave është një komponent i rëndësishëm i transparencës dhe komunikimit me publikun.

Studimet dhe analizat e revizionimeve duhet të kryhen në baza të rregullta dhe duhet të përdoren në ristrukturimin e procesit të prodhimit. Të gjitha informacionet në lidhje me procesin e revizionimit të vlerësimeve duhet të specifikohen qartë duke treguar burimet e përdorura dhe afatet e tyre kohore, numrin e planifikuar të revizionimeve, arsyet dhe kalendarin e tyre. Politika e revizionimit duhet t'i komunikohet paraprakisht përdoruesve të të dhënave.

Revizionimet e rastit, që nuk përfshihen në politikën e revizionimit, duhet të dokumentohen dhe justifikohen. Përdoruesit duhet të informohen për këto ndryshime, arsyet përse ndodhin dhe metodologjinë ku bazohen këto ndryshime. Këto njoftime duhet të publikohen në formën e artikujve në faqen e internetit të cilat përshkruajnë natyrën e çdo revizionimi që është planifikuar jashtë procesit të rregullt.

Dokumentimi i procesit të revizionimeve duhet të prodhohet dhe të arkivohet në të gjitha fazat e procesit, nga prodhimi deri tek shpërndarja. Dokumentacioni duhet të përfshijë indikatorë të cilësisë së procesit, siç janë treguesit e kohëzgjatjes, mbulimi dhe mosrespektimi, qëndrueshmëria dhe krahasueshmëria me kalimin e kohës.

Koncepti i revizionimeve është shumë i rëndësishëm jo vetëm për Eurostat por edhe për autoritetet statistikore kombëtare sepse disa burime shtesë mund të jenë të nevojshme për mbledhjen e të dhënave me qëllim rritjen e cilësisë së të dhënave në të ardhmen. Kjo do të ishte në përputhje me rekomandimet dhe praktikat ndërkombëtare dhe do të ofronte ndihmë për të pasur një pamje gjithëpërfshirëse të veprimtarive zhvillimore për të prodhuar statistika në Evropë. Roli i Eurostat-it është të konsolidojë të dhënat dhe të sigurojë që ato janë të

krahasueshme, duke përdorur metodologjinë ESA 2010 me qëllim harmonizimin e statistikave të vendeve antare të Bashkimit Evropian.

II. Llojet e revizionimeve

Duke marrë parasysh shkaqet e ndryshme të revizionimeve dhe frekuencave të ndryshme, revizionimet klasifikohen në:

2.1 Revizionime rutine

Revizionimet rutine janë të nevojshme sepse vlerësimet paraprake të agregatëve ekonomikë shpesh mbështeten në të dhëna të përkohshme, bazuar në rezultate të pjesshme. Rëndësia e formimit të politikave të rishikimit të treguesve statistikorë dhe analizimi i revizionimeve njihen gjerësisht në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Revizionimet rutinë i referohen ndryshimeve të bëra në të dhënat ekonomike të publikuara fillimisht dhe në publikimet pasuese të tij për një tremujor ose vit të veçantë referimi.

Revizionimet rutinë klasifikohen në:

- Revizionime rutinë tremujore
- Revizionime rutinë vjetore

Revizionimet rutinë tremujore, vlerësimi i Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) me frekuencë tremujore publikohet 90 ditë pas periudhës referencë. Të dhënat që bëhen të disponueshme për tremujorin e fundit kanë efekt edhe në revizionimin e tremujorëve paraardhës si rezultat i përditësimeve ose ndryshimeve administrative të burimeve të dhënave për tremujorët e mëparshëm.

Rishikimet e të dhënave të përshtatura sezonalisht konsiderohen gjithashtu si revizionime rutinë, nëse janë shkaktuar nga rishikimet e vlerësimeve të pa përshtatura sezonalisht ose përfshirja e tremujorit të fundit në serinë mbi të cilën do aplikohet zhveshja nga sezonaliteti dhe rrjedhimisht ndikohen vlerësimet e tremujorëve të mëparshëm.

Revizionime rutinë vjetore, duke qenë se vlerësimi i PBB-së tremujore mbështetet në të dhënat vjetore, ndryshimet që do të ndodhin në PBB-në vjetore do të reflektohen dhe në seritë tremujore. Ndryshimet vjetore vijnë si rezultat i përmirësimeve të burimeve ekzistuese vjetore apo të përfshirjes së burimeve të reja. Vlerësimi i një viti kalon në dy etapa derisa arrin tek vlerësimi final i tij (vlerësime semi-finale dhe finale). Ndryshimet që ndodhin në këto etapa reflektohen dhe në seritë tremujore. Efektet e ndryshimeve vjetore duke qenë se kanë një mospërputhje kohore relativisht të gjatë (vjetorja semi-finale del 15 muaj më vonë dhe finalja 27 muaj më vonë), japin një efekt më të madh dhe më të shtrirë në kohë në seritë tremujore.

2.2 Revizionime madhore

Revizionimet madhore kryhen në intervale shumë më të gjata. Qëllimi i këtyre revizionimeve është të përfshijnë burimet kryesore të të dhënave të reja dhe ndryshimet kryesore në metodologjinë statistikore ndërkombëtare (si p.sh. ESA 2010). Këto revizionime përfshihen në

shumë vite në mënyrë që të krijonë seri më të gjatë kohore dhe të qëndrueshme. [Kodi i Praktikës](#) i miratuar nga Eurostat dhe Institutet Kombëtare të Statistikave të Bashkimit Evropian, sipas parimeve të tij mbi "Proçedurat e duhura statistikore" përcakton;

- Revizionimet duhet të ndjekin proçedurat standarde, të themeluara dhe transparente (pika 8.6).
- Gabimet e zbuluara në statistikat e publikuara korrigjohen në datën më të hershme të mundshme dhe publikohen (pika 6.3).
- Njoftohen paraprakisht revizionimet kryesore ose ndryshimet në metodologji (pika 6.6).
- Revizionimet analizohen rregullisht për të përmirësuar proçeset statistikore (pika 12.3).

III. Raportet e cilësisë dhe vlerësimi

Një element i rëndësishëm i kësaj politike është edhe mënyra si vlerësohen politikat dhe praktikrat e rishikimit të Llogarive Kombëtare brenda kontekstit të raporteve të cilësisë dhe vlerësimit. Mbështetur në Parimin 8 të Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane, revizionimet do të ndjekin proçedura standarte, të mirë vendosura dhe transparente. Për të përmbushur këtë kërkesë, në faqen e Web-it të Institutit të Statistikave do të vihen në dispozicion metadat e Llogarive Kombëtare.

Të dhënat e Llogarive Kombëtare të prodhuara dhe të transmetuara në EUROSTAT, brenda një viti kalendarik, do i nënshtrohen raportimit dhe vlerësimit të cilësisë gjatë vitit pasardhës. Ky proçes synon të finalizohet deri në vitin 2022.

Zgjedhja e indikatorëve që do të përdoren gjatë proçesit të revizionimit do kryhet në përputhje me Politikën Evropiane të Harmonizuar të Revizionimit të treguesve makroekonomikë (HERP-eng).

IV. Komunikimi me përdoruesit

Informimi i përdoruesve lidhur me revizionimet e mëdha statistikore është një element i rëndësishëm në prodhimin e statistikave kombëtare. Këto revizionime ndikojnë ndjeshëm në aspektin makroekonomik dhe social, dhe vijnë për shkak të ndryshimeve në metodat statistikore, konceptet, përkufizimet, klasifikimet për të përmirësuar të dhënat e burimeve gjatë periudhës së krahasimit. Komunikimi i revizionimeve të mëdha statistikore bazohet në praktikrat që ndjekin të gjitha vendet e Bashkimit Evropian:

- **Paralajmërimi:** U komunikohet të gjithë përdoruesve arsyet kryesore të revizionimit të të dhënave, variablat dhe periudhat e mbuluara.
- **Dokumentacioni:** Revizionimet e mëdha shoqërohen me dokumentacion të mjaftueshëm duke i lejuar përdoruesit të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme situatën makroekonomike më të fundit. Dokumentacioni duhet të detajojë arsyet për revizionimin, të vlerësojë ndikimin e tyre në agregatët kryesorë, dhe të sqarojë çdo thyerje të nënkuptuar në seritë kohore ose mospërputhjet e statistikave të rishikuara. Është e

nevojshme që përdoruesit të njihen me kalendarin e revizionimeve. Dokumentacioni duhet gjithashtu të vihet në dispozicion për Eurostat.

- **Komunikimi për revizionimet e mëdha:** Komunikimi për revizionimet të cilat vijnë si pasojë e ndryshimit të koncepteve, përkufizimeve apo klasifikimeve të Bashkimit Evropian, të amendamenteve apo akteve ligjore evropiane që ndikojnë në të gjitha ose shumë prej shteteve anëtare, si dhe koha dhe zbatimi i këtyre revizionimeve, duhet të koordinohen me kujdes bazuar në Sistemin Evropian Statistikor ([ESS](#)).

V. Referenca

ESA 2010, European System of Accounts 2010, EUROSTAT, Luxembourg.

<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5925693/KS-02-13-269-EN.PDF/44cd9d01-bc64-40e5-bd40-d17df0c69334>

Dissemination policy & guidelines, 2018, Albanian Institute of Statistics, Albania.

<http://www.instat.gov.al/media/4193/dissemination-policy-guideline.pdf>

A Harmonised European Revision Policy for Macroeconomic Statistics, EUROSTAT, Luxembourg.

<https://circabc.europa.eu/sd/a/370b7c25-142d-40df-8397-248289a03bac/2017-10-13%20-%20CMFB%20Communication%20on%20common%20revision%20policies.pdf>

Practical guidelines for revising ESA 2010 data, EUROSTAT, Luxembourg.

<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/9530664/KS-GQ-18-012-EN-N.pdf/19dc3542-aa34-4b6b-a981-8a4f244074e8>